



MISIONI SHQIPTAR

E Lumja Nënë Tereza

Blessed Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12:00 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

Kush është Jezu Krishti ?


24 Gusht 2014



Në atë kohë, kur Jezusi arriti në krahinën e Cezaresë së Filipit, i pyeti nxënësit e vet: “Ç’thonë njerëzit, kush është Biri i njeriut?” Ata u përgjigjën: “Disa thonë se është Gjon Pagëzuesi; do të tjerë Elia; do të tjerë Jeremia ose një ndër profetë.” “Po ju – u tha atyre – ç’thoni: kush jam unë?” Iu përgjigj Simon Pjetri: “Ti je Mesia, Biri i Hyjit të gjallë!” Atëherë Jezusi i tha: “I lumi ti, o Simon, biri i Jonës, sepse këtë nuk ta zbuloi mishi e gjaku, por Ati im që është në qiell! Edhe unë po të them: Ti je Pjetër – Shkëmb, dhe mbi këtë shkëmb unë do ta ndërtoj Kishën time, dhe dyert e ferrit s’do të ngadhënjëjnë kundër saj! Ty do t’i jap çelësat e Mbretërisë së qiellit: gjithçka të lidhësh mbi tokë, do të jetë e lidhur edhe në qiell, e gjithçka të zgjidhësh mbi tokë, do të jetë e zgjidhur edhe në qiell.” Atëherë u urdhëroi nxënësve që të mos i tregojnë askujt se është ai Mesia. Mt 16, 13-20

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:00 te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke, M8W 3V7** (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: **www.ourladyofmm.com** ose kunsulto harten e ketushme.



Kalendari liturgjik...

25 Gusht	Shen Ludoviku
26 Gusht	Shen Aleksandri
27 Gusht	Shen Monika
28 Gusht	Shen Augustini
29 Gusht	Martirizimi i Gjon Pagëzuesit



Lutja për vizitë të suksesshme dhe të bekuar të Atit të shenjtë, Françeskut Papë në Shqipëri
Veprim përgatitor për ardhjen e Françeskut Papë në Shqipëri

“O Atë i mirë, me ndërmjetësimin e Nënës së Këshillit të mirë,

të cilën etërit tanë e zgjodhën për mbrojtëse dhe pajtore,
të të Lumturës Nënë Terezë dhe të Shërbëtorëve të Hyjit,
po Të lutemi, që vizita që Ati i shenjtë, Françesku Papë,

do ia bëj Vendit tonë, të jetë e suksesshme dhe plot bekim.
Përtërije në dashuri për Ty dhe për njëri-tjetrin mbarë popullin shqiptar:
të moshuarit, burrat dhe gratë, fëmijët dhe të rinjtë,

që të gjithë së bashku, në Hyjin, të jemi shembull i shenjtërisë së jetës.

Bëj që të Krishterët të shkojnë pas Krishtit dhe ta dëshmojnë,
para njerëzve të kohës sonë dhe brezëve të reja.

Vizita e Pjetrit të ditëve tona le të jetë për ne nxitje,

forcë dhe shërim i shpirtit tonë të vuajtur,

që me gatishmëri, gjithmonë t'i jetojmë vlerat e vërteta,
që burimin e kanë në dashurinë e Krishtit.
Së bashku më Atin e shenjtë, Françeskun Papë,
na vizito, o Shpirti Shenjt dhe përtërije fytyrën e Vëndit tonë,
dhe në të, përtërij të gjithë bijtë e bijat e tua, Shqiptar!
Amen.

Midland Ontario, shtegtim, pelegrinazh, te dielen 31 gusht....



Te dielen 31 gusht do te vizitojme vendin e shenjte dhe historik te Martyrs' Shrine ne Midland. **Aty do kemi Meshen ne oren 2 dhe bekimin me reliket (relics) e shenjtëve**, si edhe viziten e pjese se vjeter historike (shih: <http://martyrs-shrine.com>). Kush deshiron nisja nga Browns Line do te jete ne oren 10:30 me autobus. **Çmimi per person ne autobus eshte 20 dollare** (pjesen tjeter te shpenzimit te autobuzit do ta mbuloje Kisha).

Pra nuk do te kete Meshe ne Browns Line, por do te jete ne Midland. Per informacion: 647-558-9382.

Hakun e Kishes per vitin 2014

e ka dhene:

Aleks	Coku
Altin	Miri
Angjelin	Kaçaj
Anton	Malaj
Anton	Tinaj
Anton	Brunga
Arben	Toma
Arben	Pepa
Arben	Marku
Ardian	Preçetaj
Arjana	Nati
Astrit	Simeqi
Aurel	Vata
Beniamin	Hasko
Edmond	Kacorri
Eduard	Shkreli
Erion	Tase
Flobenc	Shkalla
Gjergj	Nikolla
Ladi	Lumaj
Lekë	Tarazhi
Leks	Dragu
Luigj	Narkaj
Luk	Gjolaj
Marash	Martinaj

Marin	Muzhani
Mario	Martini
Mark	Shkreli
Martin	Pjetri
Mhill	Ftoni
Ndok	Macaj
Ndue	Cacaj
Nik	Biçi
Nush	Dokaj
Paulin	Lukani
Petrit	Ujka
Pjerin	Kalaj
Pjeter & Bep	Dreshaj
Prek	Lekaj
Prek	Frani
Prek	Spaqi
Prek	Kaçaj
Preke	Gjonaj
Roza	Kalaj
Rrok	Gjoni
Sander	Kosmaci
Sokol	Ujka
Sokol	Gashaj
Tom	Ulaj
Ton	Vocaj
Vaso	Gjuravcaj
Viktor	Pleti
Viktor	Gjokaj
Vladimir	Doda
Zef	Deklaj

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

Per Hakun e Kishes: Vini re...

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollare dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misioninenetereza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa Mission), **ne nje shume te vetme ose pjese pjese gjate vitit. Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.**

Per fondin Building Fund...

Per fondin 'Building Fund' te Misionit tone **Ndue Kabashi** i ka dhene **600 dollare.**

Papa Françesku për Papën, Kishën e Botën: intervista



Gushti shkëput nga kalendari fletën e 22-të. Mbetet më pak se një muaj nga vizita e Papës Françesku në Shqipëri. Shfletojmë një nga intervistat e Papës dhënë mjeteve të ndryshme të komunikimit, për ta njohur më nga afër, me fjalët e tij. Kjo pjese interviste

u botua më 29. 06. 2014, në faqen e parë të gazetës romake **'Il Messaggero'**, me titull: "Devijimi moral, i duhet vënë pritë", pas takimit të Atit të Shenjtë me gazetaren.

Pse Ju, që në fillim, deshët ta nënvizoni fort rolin e Ipeshkvit të Romës?

"Shërbimi i parë i Françeskut është ky: të bëjë ipeshkvin e Romës. Të gjithë titujt: Papë, Bari universal, Mëkëmbës i Krishtit etj etj, i ka pikërisht sepse është Ipeshkëv i Romës. Gjëja e parë, kjo! Pasojë e parisë së Pjetrit. Nëse nesër Papa do të dëshironte të bënte ipeshkvin e Tivolit, është e qartë se do t'i tregonin derën".

Dyzet vjet më parë, nën papninë e Palit VI, Vikariati organizoi një takim kushtuar të këqijave të Romës. Qytet ku, si asokohe, ashtu edhe sot, kush ka më shumë, zgjedh më të mirën, duke i lënë, si zakonisht, më të keqen, atij që ka më pak. Sot, sipas Jush, cilat janë të këqijat e këtij qyteti?

"Janë ato të metropoleve, si Buénos Ájres. Njëri vijon të pasurohet, tjetri të varfërohet gjithnjë më shumë. Nuk kam dijeni për takimin mbi të këqijat e Romës. Janë çështje ngushtësisht romake, e unë aso kohe isha 38 vjeç. Jam Papa i parë që nuk ka marrë pjesë në Koncil e edhe i pari, që studioi teologjinë e pas Konkilit e, asokohe, për ne, drita e madhe ishte Pali VI. Sipas meje, Evangelii Nuntiandi mbetet dokument i pakalueshëm.

A ekziston hierarkia e vlerave, që duhet respektuar në qeverisjen e pasurive publike?

"Natyrisht. Pasuria e përbashkët duhet ruajtur gjithnjë. E këtë duhet ta bëjë çdo politikan. Koncept i gjerë, ky, që përfshin, për shembull, edhe mbrojtjen e jetës njerëzore, të dinjitetit të saj. Pali VI pati marrë guximin të thotë se misioni i politikës është një nga format më të larta të bamirësisë. Sot problemi i politikës, nuk flas vetëm për Italinë, por për të gjitha vendet, është zhvlerësimi i saj. Politika është rrënuar nga korrupsioni, nga fenomeni i ryshfeteve, i bakshisheve. Më vjen në mendje një dokument i botuar nga ipeshkvijtë francezë 15 vjet më parë. Ishte një letër baritore, që titullohej: "Të rehabilitohet politika". Përballonte pikërisht këtë argument. Nuk do të kishte korrupsion, pa zemra të korruptuara. I korruptuari nuk ka miq, ka vetëm idiotë të nevojshëm.

A mund të na e shpjegoji më qartë?

"Fola, dy ditë më parë, për këtë argument, sepse po komentoja Leximin kushtuar vreshtit të Nabotit. Mua më pëlqen shumë të flas për leximet e ditës. Ditën e parë foli për fenomenologjinë e korrupsionit, të dytën, për mënyrën si përfundojnë të korruptuarit. Thënë me dy fjalë, i korruptuari nuk ka miq, ka vetëm bashkëpunëtorë në krim.

good comes of this writing, it must be clear even from now that it will all be thanks to the grace and mercy of God".

GUARDIAN ANGEL PRAYER



Engjëlli i Zotit, që je rojtari im,
pasi Hyji, për mëshirë të vet,
më ka lënë nën mbrojtjen tënde,
ti sot më shndrit, më mbaj,
më ruaj e më sundo. Amen.

Rocco C Lofranco LLB

The Madison Centre
4950 Yonge Street Suite 600
Toronto ON M2N 6K1

416 223 8333

Toronto • Scarborough • Mississauga • Brampton



LOFRANCO CORRIERO
PERSONAL INJURY LAWYERS

RADIO MARIA
A Christian voice in your home

Radio Maria!
Degjoje drejtpërdrejt ne
www.radiomaria.al

Sutton
SUTTON WEST REALTY INC., BROKERAGE

Miranda Bimo
Sales Representative

Bus: 416.240.1000
Cell: 647.294.8826
Fax: 416.240.1603

300-5415 Dundas St. W.
Toronto ON, M9B 1B5
mirandabimo@gmail.com

Independently Owned and Operated

Violeta Selmanaj, Broker
Tony Selmanaj, Sales Representative

Per Shitje, Blerje, Gera Shtepi, Condo A Po
Biznese Lutemi Na Kontaktoni (Shume Vite
Eksperience Ne Toronto Dhe Rrethina)

In House Mortgage Broker 25 Years
Experience Special Rates Through
Violeta and Tony Selmanaj For Fully
Qualified Applicants.
* Call for Details

Direct (416) 553-5044
Office: (905) 279-8300
Email: vselmanaj@trebnet.com

ROYAL LEPAGE Realty Centre, Brokerage
2180 Hurontario Street Mississauga, ON L5B 1M8

KODRA
TM

Produkte Shqiptare!
Prodhuar dhe importuar nga Shqiperia.

- Fergese
- Reçel fiku, pjeshke, kumbulle, qershie
- Marinade Speci, kastravec, lakre
- Specia te pjekur
- Specia djeges
- Panxhar i kuq
- Komposto kumbulle
- Uje Mineral Tepelene
- Coffee Skenderbeu

www.kodra.org

Kramer's Bar & Grill
1915 Yonge St Toronto
Per Festa Private
Kontakto Arben Toma
Tel : 647-887-9058

BEQIRI
PROFESSIONAL CORPORATION

Ylli BEQIRI CPA.CGA

Tel: 416-854-9156
Fax: 1-888-838-7736
974 The Queensway,
Toronto ON M8Z 1P6
ybeqiri@sympatico.ca
www.beqiriaccounting.com